



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1073 Prot

Tiranë më 23.4.2019

VENDIM

Nr. 4, datë 23.04.2019

Bazuar në nenin 40 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36 të Statutit të Universitetit të Tiranës, Rektorati i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 23.04.2019 në mënyrë unanime:

VENDOSI

1. Të finalizojë miratimin e Rregullores për Zgjedhjen e Këshillave të Studentëve në Univiersitetin e Tiranës sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Shpalljen e fillimit të procedurave të aplikimit për anëtarin e Bordit të Administrimit të UT-ës, të propozuar nga studentët, nga data 23 prill 2019-10 maj 2019.
3. Rikonfirmimin e grupit të punës për hartimin e Rregullores së UT-ës, ngitur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 3 datë 19.01.2017 “Për miratimin e strukturës së grupit të punës për hartimin e Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës”. Afati i dorëzimit të draft Rregullores së UT-ës nga ky grup pune të jetë deri në datën 24 maj 2019.
4. Sëbashku me Këshillin e Etikës të hartojë draftin e Kodit të Etikës për t’ia përcjellë më pas Senatit Akademik të UT-ës për miratim.
5. Dita e martë, datë 30 prill 2019, të bëhet pushim dhe të bëhet zëvendësimi i kësaj dite të shtunën, datë 4 maj 2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI


BERNARD DOSTI

